

V E N D I M
Nr. 455, datë 23. 9.1999

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.430, DATË 9.7.1998 “ PËR DHËNIEN ME QIRA TË OBJEKTEVE TË NDËRMARRJEVE, SHOQËRIVE A INSTITUCIONEVE SHTETËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8237, datë 1.9.1997 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, ndryshuar me akte të tjera ligjore dhe të ligjit nr.8333, datë 23.4.1998 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.430, datë 9.7.1998 “Për dhënie me qira të objekteve, të ndërmarrjeve, shoqërive a institucioneve shtetërore”, të bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 1, në shkronjën “b”, pas fjalëve “200-500 m²” shtohen fjalët: “...si dhe ndërtime kapacitive (rezervuarë dhe depozita karburanti, sillose etj.) të shkëputura, pavarësisht nga vëllimi i tyre.”.

- Në shkronjën “c”, pas fjalës “501 m²” shtohen fjalët: “... si dhe grup ndërtimesh kapacitive (rezervuarë dhe depozita karburanti, sillose etj.)”.

2. Në pikën 3, pas fjalëve “çmimi i qirasë” shtohen fjalët:

“... për ndërtesat dhe ndërtimet kapacitive.”.

- Po në pikën 3, në shkronjën “a”, pas fjalëve “çmimi i qirasë” shtohet fjala: “për ndërtesat.”.

Në fund shtohet paragrafi: “Për ndërtimet kapacitive, çmimi i qirasë është 3USD/m³ në muaj.”

- Në shkronjën “b”, pas fjalëve “çmimi i qirasë”, shtohet fjala: “për ndërtesat”.

Në fund shtohet paragrafi: “Për ndërtimet kapacitive, çmimi i qirasë është 2USD/m³ në muaj.”

- Në shkronjën “c”, pas fjalëve “çmimi i qirasë”, shtohet fjala: “për ndërtesat”.

Në fund shtohet paragrafi:

“Për ndërtimet kapacitive, çmimi i qirasë është 2 USD/m³ në muaj.”

3. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“Çmimi i qirasë së truallit të lirë (jo nën ndërtesë) përcaktohet sipas pikës 13 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.312, datë 30.6.1994.”.

4. Në pikën 4 pas fjalës: “pajisjet” shtohet fjala: “galeritë”.

5. Në pikën 3, në shkronjën “a” shtohet paragrafi:

“Përfshijmë, për institucionet, ndërmarrjet a shoqëritë shtetërore, me karakter kombëtar të sistemit të kulturës, rinisë dhe sporteve, çmimi dysHEME i qirasë është 3 USD/m² në muaj. Institucionet, ndërmarrjet dhe shoqëritë shtetërore, të karakterit kombëtar, përcaktohen nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.”

6. Në pikën 7, pas shkronjës “c”, shtohet pika 7/1 me këtë përmbajtje:

“Ndarja e të ardhurave nga dhënia me qira apo enfiteozë për institucionet, ndërmarrjet a shoqëritë shtetërore të sistemit të kulturës, rinisë dhe sporteve, të bëhet:

a) për objektet e dhëna me qira sipas pikës 1, shkronja “a”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.430, datë 9.7.1998 :

-90 për qind për institucionin, ndërmarrjen a shoqërine shtetërore;

- 10 për qind për buxhetin e shtetit;

b) për objektet e dhëna me qira sipas pikës 1, shkronja “b”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.430, datë 9.7.1998 :

-60 për qind për institucionin, ndërmarrjen a shoqërine shtetërore;

-25 për qind për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;

-15 për qind për buxhetin e shtetit;

c) për objektet e dhëna me qira sipas pikës 1, shkronja “c”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.430, datë 9.7.1998:

-50 për qind për institucionin, ndërmarrjen a shoqërine shtetërore;

-30 për qind për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;

-20 për qind për buxhetin e shtetit.

Kur pasuritë e institucionit, ndërmarrjes a shoqërisë shtetërore jepen tërësisht me qira apo enfiteozë:

-10 për qind për Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit;

-40 për qind për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;

-50 për qind për buxhetin e shtetit.

7. Ngarkohen Ministria Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave të nxjerrin udhëzimin e përbashkët, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko